REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PRRENJAS

Nr prot **Prrenjas me ___/___/2025**

PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR 2026-2028 I AUDITIMIT TE BRENDSHEM BASHKIA PRRENJAS

a. Qëllimi i planit Strategjik dhe misioni i Njesise së Auditit të Brendshëm.

Plani Strategjik është dokument i cili përcakton strategjinë për veprimtarinë e Auditit te Brendshëm në Bashkinë Prrenjas.Ky plan strategjik u përgatit për periudhën 2026-2028, nga Njesia e Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas.

Plani Strategjik "Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm" përfaqëson një nga veprimtaritë më të rendësishme për shërbimin e auditimit të brendshëm dhe është një element i kontrollit të brendshem,i cili hartohet për të siguruar Titullarin e Bashkisë që të gjithë veprimtaritë dhe operacionet e Bashkisë Prrenjas dhe subjekteve të varësisë së saj mbulohen me auditim nga funksioni i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Hartimi dhe miratimi i planit strategjik është kërkesë e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe përgjegjesi e njesise audituese për hartimin dhe dërgimin për miratim tek Titullari i bashkisë dhe dergimin për informim në Strukturën Përgjegjese për Harmoniziminin e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financës.

Njesia e Auditit të Brendshëm, duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin lidhur me problemet e kontrolleve të brendshme dhe administrimit, synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin me auditim të veprimtarive kryesore dhe me risk të lartë të përcaktuar në këtë plan.

Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave tre vjeçare për auditime, mbi bazën e një rishikimi të përgjithshëm të subjekteve që i nënshtrohen auditimit, identifikimit të sistemeve dhe fushave të veprimtarive mbi bazë risku, si dhe burimet njerezore të planifikuara në dispozicion të Njesise së Auditit të Brendshëm.

a) Misioni i Njesise se AB

Misioni i Njesise së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Prrenjas është që të ndihmojë titullarin për të arritur objektivat e vendosura për Bashkine Prrenjas,nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike duke vlerësuar dhe rekomanduar përmirësimin e frytshmërisë së menaxhimit të riskut dhe proceset e kontrollit te brendshëm,në drejtim të zbatimit te ligjit, rregullave dhe kontrolleve të vendosura, vleresimit të dobisë, frytshmërisë dhe efektivitetit të veprimeve si dhe e sigurisë objektive mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga struktura e menaxhimit.

b) ***Organizimi I NJAB dhe kuadri ligjor***

Njesia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Prrenjas është e organizuar si njesi në varësi të drejtepërdrejtë të Kryetarit të Bashkisë.

a. Kuadri ligjor për Auditimin e Brendshem në Vetqeverisjen vendore:

1. Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
2. Ligji nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"
3. Ligji nr. 10296, datë8.7.2010"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
4. Ligji nr. 152/2013 datë 13.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
5. Ligji nr. 10294, datë 1.07.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik.
6. VKM nr. 165, datë 2.3.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore".
7. VKM nr. 142, datë 12.3.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.

b. Kuadri ligjor për Auditimin e Brendshëm në Bashkinë Prrenjas

1. Ligjinr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";
2. Urdhri i Ministrit të Financavenr. 69, datë 29.09.2010 "Për miratimin e Manualit te auditit te brendshem
3. Udhëzimi nr. 12, date 05.06.2012"Mbiprocedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik"
4. VKM nr. 83, datë 3.2.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik
5. VKM nr. 160, datë 2.3.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike
6. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 86, datë10.12.2015 "Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik
7. Rregullorja e Brendshme të Bashkisë Prrenjas
8. Aktet te tjera ligjore e nenligjore te sisteme/fushave përkatëse objekt auditimi

c) ***Objektivat strategjik***

Objektivat strategjike te Njesise së Auditit të brendshëm janë:

- Të përdorë metodologji auditimi bashkëkohore që përputhet me standardet e pranuara ndërkombëtare të auditimit.
- Të rrisë bindjen e titullarit mbi nevojen dhe domosdoshmerine e veprimtarisë së Njesise së Auditimit të Brendshëm, si një veprimtari mbështetese që e ndihmon në arritjen e objektivave të vendosura, nëpërmjet përgatitjes dhe realizimit të planit strategjik dhe vjetor të bazuar në vleresimin objektiv të riskut, nëpërmjet vleresimit objektiv të përshtatshmerisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, bazuar në gjetjet e konstatuara të cilat kanë pasur apo mund të kenë inpakte negative në arritjen e objektivave të Bashkise Prrenjas, si dhe nëpërmjet efektivitetit të rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e tyre në të ardhmen, duke mundësuar edhe bindjen të titullareve të subjekteve të audituar për ti realizuar ato.

- Të rrisë bindjen e titullarëve të subjekteve të audituar, e nevojës dhe domosdoshmërisë së veprimtarisë së auditit të brendshëm si një veprimtari që i ndihmon ato në përmirësimin e proceseve të kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të riskut, e cila do të arrihet duke rekomanduar praktikat me të mira për krijimin e rregullave dhe procedurave specifike për çdo proces pune në subjektet që ato drejtojnë, si dhe duke përmirësuar edhe praktikat e sjelljes së rolit të auditit të brendshem, si një strukturë inspektimi financiar.

d) ***Identifikimin e subjekteve objekt auditimi.***

Për identifikimin e subjekteve objekt auditimi janë përfshire të gjitha subjektet që i nënshtrohen auditimit nga Njesia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Prrenjas, pavaresisht periudhës se kur do të auditohet për një periudhe 3 vjeçare per vitin 2026, dhe vitet 2027 dhe 2028

. Sipas një analizë të hollesishme për këtë qëllim rezultojnë 44 subjekte që i nënshtrohet auditimit:

- 4 Drejtori të Bashkisë Prrenjas
- 2 Agjenci
- 35 Sektore.
- 3 njesi administrative

e) ***Identifikimi I sistemeve dhe fushave prioritare:***

Identifikimi i Sistemeve/fushave prioritare që u nënshtrohen auditimit:

1. Për 44 subjektet që i nënshtrohen auditimit, brenda strukturës së Bashkise Prrenjas në nivel drejtorie ku përfshihen edhe 3 Njësitë administrative, kryhen planifikohen auditime përputhshmerië për vlerësimin e funksionimit sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat e veprimtarive dhe aktiviteteve te kryera për çdo strukturë të drejtorisë, në përputhje me funksionet dhe detyrat të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe objektivat e Bashkise Prrenjas në nivel drejtorie, sektori si: buxhetit, financat, monitorimin e strehimit, ndermarrjeve dhe prokurimet, zbatimin e kontratave, , kontrollit të zhvillimit të territorit,investimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm e qeverisjes punëve publike dhe monitorimit etj. si dhe për zbatimin e kompetencave të deleguara nga Njësitë Administrative.

2. Për 4 drejtorite,2 Agjenci,35 Sektoret dhe 3 Njesi administrative te bashkisë.

- Sistemit kontrollit të brendshëm, fushat e veprimtarive dhe aktiviteteve për çdo strukturë
- Sistemi i menaxhimit buxhetor/plan biznesin dhe realizimin e te ardhurave dhe shpenzimeve, rezultatin ekonomiko-financiar.
- Sistemi i menaxhimit të aseteve.
- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pagave
- Sistemi i prokurimeve
- Sistemi i pagesave
- Sistemi i kontabilitetit.

f) ***Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve:***

Gjatë hartimit të planit strategjik 2026-2028 dhe me plotesimin e srukturës së miratuar janë planifikuar për tu audituar subjekte me risk të lartë e të mesëm duke lënë për tu audituar ne periudhat e mevonshme auditime me risk të ulët.

Në planifikimin e nivelit të risqeve jemi bazuar në kompleksitetin e subjektit objekt auditimi,fushat e veprimtarisë, buxhetin, burimet njerezore, periudhën e paaudituar, gjetjet e meparshme të auditimit etj.

Identifikimi i subjekteve sipas sistemeve dhe fushave për tu audituar dhe nivelin e riskut e paraqesim në pasqyren 1, bashkelidhur.

g) ***Kufizimet e auditimit:***

Risqet e mundshme te auditimit që mund të pengojnë arritjen e objektivave parashikohen:

- Aftesitë profesionale, kualifikimi dhe përvojen e punës së audituesve që do të rekrutohen.
- Konsiderimin AB nga menaxhimit të lartë si ndihmës dhe konsulent të tij dhe mbështetje për vlerësimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm e qeverisjes.

h) **Prioritetet për 3 vitet (1 vitin e planifikuar +2 vitet e tjera):**

Të ndihmojë titullarin e bashkisë dhe personave pergjegjes te subjekteve vartëse të saj, nëpërmjet kryerjes së auditimeve përputhshmerie, financiare, performance dhe të kombinuara, në dhënien e vlerësimit të efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, pajtueshmërisë akteve të brendshme e kontratat me legjislacionin,ruajtja e aseteve, si dhe vleresimi i besueshmërisë dhe plotesisë së informacioneve operative e financiare.

PLANI VJETOR 2026

Hartimin e planit vjetor 2026 e mbeshtesim në këta tregues:

a) Në zhvillimet aktuale të Njesise së Auditit të Brendshëm dhe Strukturen aktuale me të cilën funksionon aktualisht Njesia e Auditit të Brendshëm.
b) Prioritet e auditimit e vendosura gjatë vitit 2026, referuar planit vjetor të propozuar dhe kërkesave të titullarit për të kryer angazhim/auditimi.
c) Objektivi kryesor për vitin 2026,
d) Programimi i llojit të angazhimeve.
e) Planifikimi i burimeve për viti2026
f) Planifikimi i kostos për vitin 2026.
g) Planifikimi i nevojave ose kryerja e trajnimeve .
h) Sigurimi i brendshëm i cilësisë.

a. Në zhvillimet aktuale te njesise së Auditit të Brendshëm dhe Strukturen aktuale me të cilën funksionon aktualisht njesia e Auditit të Brendshëm Bashkia Prrenjas.

Bazuar në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë struktura e njesise së Auditit të brendshëmne bashkine Prrenjas është miratuar me një numër punonjësish prej 3 vetesh, nje pergjegjes dhe dy specjaliste.

b. Prioritet e auditimit te vendosura gjatë vitit 2026

Prioritetet e vendosura nga njesia e auditit për vitin 2026 janë:

- Funksionimi i njesise së Auditit të Brendshëm me kapacitet të plotë sipas udhezimeve perkatese.
- Realizimin 100% të planit vjetor të veprimtarisë së auditit të brendshëm të miratuar.
- Plotesimin e standarteve të auditimit për çdo auditim të kryer.

c. Objektivi kryesor për vitin 2026,

Objektivat kryesore për vitin 2026 janë:

- Përzgjedhja e subjekteve dhe fushave gjatë planifikimit të auditimeve në:
  - Subjekte/ fusha të vlerësuara me rrisk të lartë.
  - Subjekte/ fusha që nuk janë audituar me parë.
  - Subjekte/ fusha ku ka pasur ndryshime e zhvillime gjatë veprimtarise se tyre.
  - Subjekte e fusha të vleresuara me rrisk nga titullaret e drejtorive, apo nga rekomandimet e institucionit të KLSH.
- Rritja e cilësisë dhe e performancës së auditimeve duke shtuar cilësinë e zbulimeve dhe rekomandimeve me qëllim dhënien e impaktit në rritje përsa i përket përmirësimit të menaxhimit dhe shtimit te vleres
- Shfrytezimi i burimeve njerezore të drejtorise në mënyre efektive dhe eficente.

d. Llojin e angazhimit të auditimit.

Për hartimin e planit të veprimtarisë audituese për vitin 2026 u bazuam në strukturën e miratuar dhe në kohen e punës që zë çdo proces pune audituese sipas stadeve të auditimit, që mund të kryej një auditues/grup auditimi gjatë një viti.

Për auditimin e llojit"shërbim konsulence" nuk e kemi parashikuar, pasi nuk kemi pasur kërkesa nga titullari i bashkise Prrenjas .

Llogaritja e diteve të punës që i duhen grupit të auditimit për kryerjen e një angazhim auditimi bazuar në kompleksitetin e subjektit/fushës objekt auditimi dhe procedurat e punës për një auditim, janë përllogaritur me 591 dite per 3 persona sipas pasqyres perkatese.

e. Llogaritjen e kostos për vitin 2026.

Planifikimi i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të Njesise së Auditit të Brendshëm është bërë sipas kërkesave të përcaktuara në manualin e auditit të brendshëm, formatit standart, ditet e festave zyrtare të marre nga faqja e internetit, numri i punonjesve i miratuar dhe jo faktik duke bërë të mundur hartimin e pasqyrës nr. 5 bashkëlidhur, në përputhje me përcaktimet e manualit të auditimit të brendshëm

f. Planifikimi i nevojave ose kryerja e trajnimeve të stafit,

Planifikimi i nevojave ose kryerja e trajnimeve të stafit është bërë sipas pasqyres nr. 4 bashkëlidhur, duke vlerësuar nevojat për trajnimeve në fusha të caktuara të auditimit si dhe kryerjen e tyre në periudhën me të përshtatshme bazuar edhe në praktikat e deritanishme të organizimit të trajnimeve nga strukturat pergjegjese për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave.

BAZUAR NE RELACIONIN E PARAQITUR KERKOJME:

1. Miratimin nga Titullari i Bashkisë të planit strategjik 2026-2028, të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Prrenjas, sipas pasqyrave bashkëlidhur.

2. Miratimin e planit vjetor të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Prrenjas për vitin 2026, sipas pasqyrave bashkëlidhur.

Plani strategjik dhe vjetor pas miratimit, bazuar në shkronjen "c" do t'i dërgohet për informacion
Struktures Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave.

Bashkëlidhur:

1. Pasqyra Nr.1: Vleresimi I Nivelit te Riskut per subjektet per vitin 2026
2. Pasqyra Nr.2: Plani strategjik i subjekteve te synuara për t'u audituar për vitin 2026-2027-2028)
3. Pasqyra Nr.3: Plani vjetor për vitin 2026
4. Pasqyra Nr.4: Planifikimi vjetor i nevojave per trajnim per vitin 2026
5. Pasqyra Nr.5: Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shperdarja e burimeve për vitin 2025

Faleminderit!

NJESIA E AUDITIT TE BRENDSHEM

Bashkia Prrenjas